

Bazuar në Urdhrin nr. 4212 Prot., datë 30/06/2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të Institutit të Sigurimeve Shoqërore “Për hapjen e procedurës së rekrutimit të personelit nëpërmjet konkurimit të hapur”, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, bën shpalljen e vendit të lirë të punës për pozicionin:

1. Specialist në Sektorin e përfitimeve afatshkurtra / Drejtoria e përfitimeve / ISSH.
1 vend pune

Kandidati konkuries:

- Duhet të zotërojë diplomë të nivelit “Master profesional” ose të barazvlefshme me të, sipas legjislativit të arsimit të lartë, në Mjekësi;
- Të ketë të paktën dy vjet punë në nivel specialisti në administratë publike/shërbim civil ose minimumi dy vjet punë në sektorin privat në profesion.

Kandidati që konkuron duhet të plotësojë kërkesat si më poshtë:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtjeje penale me dashje;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga sistemi i sigurimeve shoqërore, shërbimi civil ose administrata publike, që nuk është shënuar, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Fushat e njojurive, aftësitë dhe cilësitetë mbi të cilat do të zhvillohet testimi me shkrim & intervista

Kandidatët do të testohen në lidhje me:

- Njohuritë në fushën e sigurimeve shoqërore (statusi i ISSH-së, Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar);
- Njohuri të Rregulloreve të përfitimeve, kontributeve, financiare, personelit dhe për sistemin e informacionit të ISSH;
- Njohuri të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat";
- Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë;
- Njohuri të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënavë personale";

- Njohuri të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”;
- Njohuri të Ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Në vlerësimin e kandidatëve, përfshihen:

- a) vlerësimi i jetëshkrimit të kandidatëve: që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën;
- b) vlerësimi me shkrim: që konsiston në vlerësimin e njohurive për legjislacionin e zbatueshëm për sigurimet shoqërore, organizimin administrativ në sistemin e sigurimeve shoqërore, për nivelin e njohurive akademike dhe profesionale, bazuar në kriteret e përcaktuara;
- c) intervista me gojë, ku zhvillohet intervistimi i kandidatëve, i cili synon të evidentojë formimin e përgjithshëm, si dhe vizionin e tyre mbi veprimtarinë e sigurimeve shoqërore dhe për pozicionin që konkurohet.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100, të cilat ndahen përkatësisht:

- a) për vlerësimin e jetëshkrimit (CV) të kandidatëve, deri në 20 pikë;
- b) për intervistën me gojë, deri në 40 pikë;
- c) për vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë.

Kandidati konkuries kualifikohet nëse në total ka fituar mbi 70 pikë, nga 100 pikë të mundshme, gjatë fazës së vlerësimit.

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat me postë, në zyrën e protokollit të ISSH-së, si më poshtë:

- Një kërkesë për konkirim për pozicionin e punës për të cilin janë të interesuar;
- Një kopje të jetëshkrimit (CV);
- Fotokopje të diplomës dhe listës së notave (e noterizuar);
- Vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- Raport të aftësisë për punë
- Fotokopje të librezës së punës;

- Certifikata ose dëshmi të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme;
- Fotokopje të Kartës së identitetit.

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave me postë, duhet të bëhet brenda datës 13.07.2021, pranë zyrës së prokoll/sekretarisë në ISSH.

Nuk pranohen në konkurim kandidatët që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara më lart.

Testimi me shkrim do të zhvillohet në ambjentet e ISSH-së në datën **15.07.2021, ora 10.**

Intervista me gojë do të zhvillohet në ambjentet e ISSH-së në datën **19.07.2021, ora 10.**